

**VENDIM**  
**Nr.1320, datë 24.9.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË**  
**PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI**  
**MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**V ENDOSI:**

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, përmasat e pronës “Reparti i policisë, Brisku”, sot “RESI”, në inventarin e miratuar për Ministrinë e Rendit Publik, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

FORMULARË PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE  
INSTITUCIONI I PUSHTETIT QENDROR MB (Reparti Special RESI)

Bashkia –Tiranë

Fusha e përdorimit të pronës: ruajtje rendi

| Nr<br>rendor | A                                     |                 | B                 |                            |                                          |                                                          | C                                                 |                                                       |                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|--------------|---------------------------------------|-----------------|-------------------|----------------------------|------------------------------------------|----------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|-------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|              | Zona<br>kadas.<br>indeksi i<br>hartës | Nr.<br>pasurisë | Lloji i<br>pronës | Emri i<br>pronës<br>Adresa | Sip.totale e<br>pronës (m <sup>2</sup> ) | Nga<br>sip.totale<br>sa<br>ndërtesë<br>(m <sup>2</sup> ) | Funksioni<br>për të<br>cilin<br>përdoret<br>prona | Institucioni/Enti<br>me përgjegjësi<br>administrative | Institucioni<br>përdorues<br>Statusi<br>juridik i<br>përdorimit | Të dhëna të tjera<br>(Shënime të veçanta)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| 1            | 2                                     | 3               | 4                 | 5                          | 6                                        | 7                                                        | 8                                                 | 9                                                     | 10                                                              | 11                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| 1            |                                       |                 |                   | Reparti<br>special<br>RESI | 1710                                     | 1153                                                     | Ruajtje<br>rendi                                  | Ministria<br>e Brendshme                              | Reparti<br>special<br>RESI                                      | Sipas VKM nr.250, datë<br>24.4.2003 përfshihet prona e<br>repartit policisë Brisku sot<br>reparti special RESI në<br>formularin nr.1, të inventarit<br>të pronave të paluajtshme<br>me numër rendor “1” me<br>sipërfaqe totale prone 1690<br>m <sup>2</sup> , me sipërfaqe ndërtese<br>852 m <sup>2</sup> .<br><br>Nga matjet faktike nga inxh.<br>të licenc. si dhe nga harta<br>treguese në ZRPP sipërfaqet<br>reale janë:<br>sipërfaqe totale prone 1710<br>m <sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtese<br>1153 m <sup>2</sup> |

